



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë

06. nr. 350 - 2979 / 2014

Klinë, më datën, 16.05.2014.

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapsinor, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH-or nr.05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të planifikimit hapsinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapsinor, si dhe duke iu referue përgjegjësiqe qe dalin nga neni 79 i Statutit të Komunës se Klinës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë, lëshon këtë:

N J O F T I M

Përmes të cilit njoftojm të gjithë qytetaret, grupet e interesit dhe institucionet komunale etj. qe nga data 27/05/2014, duke filluar nga ora 10.00h në sallën e Kuvendit Komunal në Klinë, në pajtim më nenin 17 parag. 5 i Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapsinor, organizohet:

DEBATI PUBLIK

për

Projekt dokumentin e Planit Rregullues Urban-PRRU të Klinës

Qëllimi i shqyrtimit publik është qe Projekt dokumenti i Planit Rregullues Urban-PRRU të Klinës, i cili në parim ka marr Pëlqimin nga Autoriteti i planifikimit-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë, tani për të njejtin dokument të merrën: opinione, sugjerime, komente, propozime apo edhe mendime profesionale etj. të cilat derivojn nga debati dhe të njejtat mund të inkorporohën në Projektplanin Rregullues Urban i cili më pastaj deregohet në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Të gjithë qytetarëve, grupeve të interesit, bartësve të institucioneve publike në komunë, anëtarve të Kuvendit të Komunës dhe të interesuarve të tjerë, përmesë kopjeve të projekt dokumentit të punuar nga Kompania „URBAN PLUSI,, me seli në Prishtinë, ashtuqë përmes këtij debati subjekteve të lartcekur iu mundsohet qe të kontribuojnë në dhënjen e: komenteve, sugjerimeve, mendimeve profesionale, propozimeve apo edhe keshillave përkatëse të cilat do të jenë me interes për projekt dokumentin e tillë por edhe për të gjithë qytetaret dhe banoret e Komunës se Klinës.

Përiudha për shqyrtim dhe komentim zgjatë 30 ditë nga data e fillimit të debatit publik (neni 17 parag.5 i Ligjit nr..04/L-174).

Komuna mbrënda 30 ditëve pas përfundimit të shqyrtimit publik i shqyrton, analizon dhe inkorporon ligjrisht propozimet dhe kontributet tjera qe derivojn nga debati publik para se këto të i dergohën Kuvendit Komunal për shqyrtimin dhe aprovimin meritor përfundimtar (neni 17 parag. 6 i Ligjit nr.04/L-174).

Komentet në formë të shkruar apo çfardo forme tjetër e kontributit mund të dërgohet në Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë dhe ato do të mund të përfshihën në Raportin mbi shqyrtimin publik të cilin do ta hartoj Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes se Mjedisit në Klinë.

Projekt dokumenti i Planit Rregullues Urban-PRRU i Komunës se Klinës, mund të merret si kopje në Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë por i njëjti dokument do të mund të gjindet dhe shkarkohet edhe nga ueb faqja zyrtare e Komunës se Klinës, kk.rks-gov.net/klina/.

Njoftimi i tillë publikohet në: Tabelën komunale të shpalljeve, në ueb faqën zyrtare të komunës, pastaj në shtypin e përditshem, një kopje i dergohet MMPH-or në Prishtinë-Departamentit të Planifikimit hapsinor si dhe një kopje i mbetet arhivës komunale.



D r e j t o r i :

[Signature]
z. Baki Gashi